



Republika e Kosovës- Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

**PLANI I VEPRIMIT PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË
KUFIZUAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS (2021-2023)**

ZYRA E KRYEMINISTRIT / ZYRA PËR QEVERISJE TË MIRË

Ky dokument paraqet vazhdimësinë e veprimeve dhe politikave në nivel vendi për zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023

Shtator, 2021

Falënderim

Si në çdo proces të hartimit të dokumenteve të kësaj natyre, pa bashkëpunimin e ndërsjellë dhe pa punën e përbashkët të institucioneve përkatësisht ministritë e linjës dhe të organizatave të personave me aftësi të kufizuar nuk do të ishte i mundur hartimi i Planit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2021-2023.

Kontributi dhe puna e përbashkët kanë mundësuar që ky dokument të përfshijë për të tretën herë radhazi, periudhën tre vjeçare me të gjitha prioritetet dhe veprimet për përmirësimin e cilësisë së jetës së Personave me Aftësi të Kufizuar.

Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, e cila tashmë është e mandatuar të koordinojë këto procese, falënderon të gjithë akterët pjesëmarrës për kontributin e dhënë në hartimin e këtij dokumenti qeveritar dhe të gjithë dokumenteve që i kanë paraprirë dokumenteve të kësaj natyre, duke përfshirë ministritë e linjës, shoqatat për persona me aftësi të kufizuar dhe partnerët ndërkombëtar.

PËRMBAJTJA

Falënderim	2
AKRONIMET	Error! Bookmark not defined.
HYRJA	Error! Bookmark not defined.
ANALIZA E TË ARRITURAVE TË PLANIT NACIONAL PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR 2018-2020	6
SHËNDETËSIA	8
<i>Objektiva Strategjike 1: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuar</i>	8
<i>Objektivi Specifik 1: Ngritja e kapaciteteve te personelit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore</i>	8
<i>Objektivi Specifik 2: Përfshinë, Zbulimin e hershëm dhe identifikimin e aftësisë së kufizuar prej kohës perna- tale, natal edhe postnatale</i>	8
<i>Objektivi Specifik 3: Rritja e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për PAK</i>	9
MIRËQENIA SOCIALE.....	
Objektiva Strategjike 2: Sistem funksionalë dhe i mirëfillt për mirëqenien dhe sigurinë sociale si dhe ofrimin e mundësive të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.....	9
<i>Objektivi Specifik 1: Shtrirja e shërbimeve në komunitet</i>	9
<i>Objektivi specifik 2- Përfshinë krijimin e kushteve të barabarta për Punësimin e PAK -</i>	9
<i>Objektivi specifik 3 - Aftësimi dhe riaftësimi profesional për përgatitjen e Personave me Aftësi të Kufizuara për Tregun e punës -</i>	9
ARSIMI	10
Objektiva Strategjike 3: Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara.....	10
<i>Objektivi Specifik 1: Krijimi i mekanizmeve për identifikimin dhe edukimin e hershem të fëmijëve me aftësi të kufizuara</i>	10
<i>Objektivi Specifik 2: Krijimi, fuqizimi dhe përmirësimi i shërbimeve të mekanizmeve ndër-sektorial dhe mekanizmeve tjerë mbështetës për shkollën gjithëpërfshirëse</i>	10
<i>Objektivi Specifik 3: Të krijohet një mjedis i përshtatshëm për gjithëpërfshirje ne shkollë dhe komunitet</i>	10
<i>Objektivi specifik 4: Përfshinë Ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit ne arsimin gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet e arsimit para-universitar.....</i>	10
MBROJTJA LIGJORE	10
Objektiva Strategjike 4: Qasje e barabarte në mbrojtje ligjore si dhe ofrimi i shërbimeve në nivelin lokal për përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara.....	10

<i>Objektivi Specifik 1: Hartimi i ligjeve në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara</i>	10
<i>Objektivi Specifik 2: Ndryshimi dhe plotësimi i kornizës aktuale ligjore për PAK</i>	11
<i>Objektivi Specifik 3: Ngritja e kapaciteteve të stafit profesional në sistemin e drejtësisë për të drejtat e PAK</i>	11
QASJE, INFORMIM, KOMUNIKIM, PJESEMARRJE DHE STATISTIKA	11
<i>Objektiva Strategjike 5: Krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesmarrje si dhe në krijimin apo vendosjen e një sistemi të unifikuar të të dhënave për Personat me Aftësi të Kufizuara</i>	11
<i>Objektivi Specifik 1: Hulumtimi sipas nevojës mbi gjendjen në terren lidhur me qasjen në objekte për PAK</i>	11
<i>Objektivi Specifik 2: Sigurimi i qasjes në objekte për PAK</i>	11
QËLLIMI I PLANIT NACIONAL PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA 2021-2023	11
MONITORIMI DHE RAPORTIMI	12
Ndikimet Financiare në Implementimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës (2013-2023)	13

SHKURTESAT

ZKM/ZQM	- Zyra e Kryeministrit/ Zyra për Qeverisje të Mirë
ASK	- Agjensioni i Statistikave të Kosovës
DKA	- Departamenti Komunal i Arsimit
DMS	- Departamenti i Mirëqenies Familjare
MASHTI	- Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MPB	- Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	- Ministria e Punëve të Jashtme
MKRS	- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MSH	- Ministria e Shëndetësisë
MEA	- Ministria e Ekonomisë
MMPHI	- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsionor dhe Infrastrukturës
MPBZHR	- Ministria e Pylltarisë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MAPL	- Ministria Administratës dhe Pushtetit Lokal
MD	- Ministria e Drejtësisë
MFPT	- Ministria e Financave, Punës dhe Transferve
PKVPAK	- Plani Nacional i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2023
PAK	- Personat me Aftësi të Kufizuara
PIA	- Plani Individual i Edukimit
KE	- Komisioni Evropian
OJQ	- Organizata Jo qeveritare
IKSHPK	- Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
KDPAK	-Konventa për të Drejta e Personave me Aftësi të Kufizuara
OBSH	- Organizata Botërore e Shëndetësisë
OPAK	- Organizata për Personat me Aftësi të Kufizuara
QZHMF	- Qendra e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare
DUDNJ	- Deklarata Universale për të Drejtave e Njeriut
QB	- Qendra Burimore
QAP	-Qendrat e Aftësimit Profesional

HYRJA

Realizimi i të drejtave të njeriut posaçërisht i personave me aftësi të kufizuara përbëjnë rëndësinë fundamentale për zhvillimin mbarëvajtjen e një shoqërie. Realizimi i çdo të drejte për çdo individ krijon mundësi të barabarta që çdo njeri të ketë qasjen e duhur në shoqëri e me theks të veçantë Personat me Aftësi të Kufizuara.

Në hartimin e dokumenteve të kësaj natyre Qeveria e Republikës së Kosovës ka vite që ka lansuar Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023. Poashtu Zyra për Qeverisje të Mirë lanson Planin e tretë Nacional të Veprimit në saje të Strategjisë për të bërë të mundur më hollësisht zbatimin e aktiviteteve dhe objektivave të dala nga grupet e punës. Qasja e përdorur gjatë hartimit të këtyre dokumenteve ka pasur qëllim gjithë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre.

Aktivitete dhe detyrimet e vëna në këtë dokument zgjerohen në pesë fusha me prioritet të posaçëm të jetës së qytetarëve me aftësi të kufizuara, në pajtim me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila numëron aspektet e rëndësishme jetike si: respekti për dinjitetin njerëzor, autonominë individuale për të vendosur dhe zgjedhur, mungesa e diskriminimit, përfshirja e plotë në shoqëri, respektimi i dallimeve, mundësitë e barabarta, qasja e lirë dhe pa pengesa, barazia gjinore e mbrojtja e identitetit. Në pajtim me këtë, ky dokument do shtrihet mbi aspektin shëndetësor, mirëqenie sociale dhe punësim, arsimim, mbrojtje ligjore dhe qasje të barabartë.

Miratimi i një sërë Ligjesh si Ligji për Personat e Verbër, Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji, si dhe zbatimi i Rregullores së QRK 15/2014 për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave në institucionet publike për personat e shurdhër kanë qenë disa nga arritshmëritë në përmbushjen e ngritjes së standartit të kushteve të jetës të përfituesve të kësaj kornize ligjore.

Megjithëse përkundër sfidave financiare në realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara ka akoma shumë punë që duhet bërë por më e rëndësishmja është që ekziston potenciali dhe bashkëpunimi i ndërsjellë në mes institucioneve të vendit dhe organizatave të shoqërive në këtë rast të organizatave për persona të aftësi të kufizuara.

ANALIZA E TË ARRITURAVE TË PLANIT NACIONAL PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR 2018-2020

Në dekadën e zbatimit të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2023 janë miratuar dy plane të veprimit përgjatë dhjetë vjeteshit të fundit. Rrjedhimisht edhe monitorimi i objektivave strategjike, zbatimit të tyre ka qenë më i matshëm dhe me i qasshëm. Aktivitetet dhe objektivat e përcaktuara çdo herë kanë qenë konform fushës përkatëse, përkatësisht 5 fushave të parapara të cilat mbulojnë më me prioritet të drejtat themelore të personave me aftësi të kufizuar.

ZKM/ZQM në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse në baza vjetore ka paraqitur të gjitha arriturat dhe sfidat e zbatimit të dokumenteve në fjalë. Në këtë kontekst janë publikuar tri raporte të progresit 2013-2014, 2015, 2019.

Fushat e intervenimit çdo herë kanë përfshirë fushat më me prioritet në përmirësimin e cilësisë së jetesë të personave me aftësi të kufizuara.

Gjatë periudhës Qershor - Korrik 2019, janë mbajtur 10 forume këshilluese në nivelin komunal për të identifikuar nevojat për Planin e Veprimit të Aftësisë së Kufizuar 2021-2023. Takimet janë organizuan nga **ZKM/ZQM** dhe **HANDIKOS** në partneritet me SHKV dhe SHKSH në kuadër të projektit “Promovimi i gjithëpërfshirjes dhe shtrirja e proceseve këshilluese për qeverisjen dhe reformat e administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal” i cili është financuar nga Bashkimi Evropian.

Mbi 300 persona me aftësi të kufizuara, përfaqësues lokalë të DPO-së dhe përfaqësues të institucioneve vendore nga komunat Prishtinë; Prizren Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Vushtri; Suharekë dhe Drenas kanë qenë pjesëmarrës në këtë ngjarje ku ata ofruan kontributet e tyre lidhur me zbatimin aktual të Planit të Veprimit dhe kontribuan në identifikimin e nevojave për Planin Kombëtar të Veprimit 2021-2023.¹

COVID-19 ka krijuar një krizë njerëzore të një shkalle të tillë e cila nuk ka qenë e përjetuar deri më tani dhe e cila ka ndikuar në mënyrë dis-proporcionale edhe tek personat me aftësi të kufizuara. Si e tillë kjo situatë kërkoi një përgjigje të pa zbatuar më parë - një qasje të jashtëzakonshme të mbështetjes së personave me aftësi të kufizuara. Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK) vepruan krahas mundësive të tyre për të mbështetur anëtarët e tyre, gjithmonë në harmoni me rekomandimet, instruksionet dhe dokumentet tjera relevante të cilat janë publikuar nga OKB, OBSH, IKSHKP dhe Qeveria e Kosovës.

Qëllimi kryesorë ishte për t’u siguruar që personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje në shërbimet bazike, përfshirë shërbimet e menjëhershme shëndetësore dhe të mbrojtjes sociale, për të kapërcyer krizën.² Dokumentet e publikuara nga OKB në referencë të pandemisë COVID 19, prezantuan të gjeturat, udhëzimet dhe rekomandimet të cilat OPAK-ët në Kosovë i zbatuan gjithmonë duke u fokusuar në nevojat dhe specifikat e anëtarëve të cilët përfaqësonin. Rekomandimi kryesorë i OKB-së ishte se një reagim për rimëkëmbje nga COVID 19 duke përfshirë aftësinë e kufizuar do t’i shërbejë më mirë të gjithëve. Këto rekomandime specifike ishin përqendruar në sektorët kryesorë që përfshinin katër fusha kryesore të veprimit të zbatueshme për të gjithë: 1. Sigurimi i integritit të aftësisë së kufizuar në të gjitha veprimet e rikuperimit nga COVID-19; 2. Sigurimi i qasjes në informata, pajisje, shërbime dhe programe në përgjigjen dhe rikuperimin nga COVID-19; 3. Sigurimi i konsultimeve kuptimplota me pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese në të gjitha fazat e përgjigjes dhe rimëkëmbjes COVID-19; 4. Krijimi i mekanizmave për të siguruar përfshirjen e aftësisë së kufizuar në përgjigjen ndaj COVID-19.³

Raporti i OKB-së, gjithashtu ka prezantuar një gamë të gjerë të ndikimit të COVID-19, tek personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe implikimet afatshkurtra dhe afatgjata.

¹ Përmbledhje e nevojave të qytetareve me Aftësi të Kufizuara për Planin e Veprimit 2021-2023, European Union Kosovo; Handikos; Dhjetor 2019

² RAPORTI VJETOR PËR AFTËSINË E KUFIZUAR, Zyra e Bashkimit Evropian; Handikos 2020

³ United Nation/Policy Brief/ A Disability -Inclusive Response to COVID-19, May 2020 <https://reliefweb.int/report/world/policy-brief-disability-inclusive-response-covid-19-may-2020>; RAPORTI VJETOR PËR AFTËSINË E KUFIZUAR, Zyra e Bashkimit Evropian; Handikos 2020

Ndër të tjera është konkluduar, se: Personat me aftësi të kufizuara janë në rrezik më të madh të infeksionit nga COVID-19; kanë rrezik më të madh për të zhvilluar gjendje më të rëndë shëndetësore dhe vdekje; personat me aftësi të kufizuara që jetojnë në institucione kanë më shumë gjasa të preken nga virusi dhe kanë nivele më të larta të vdekshmërisë; të njëjtit janë veçanërisht në dis-avantazh nga pasojat socio-ekonomike dhe masat për të kontrolluar pandeminë; ndikimi në punësim dhe mbrojtje sociale; arsim; shërbimet mbështetëse; dhe ndikimet e dhunës tek personat me aftësi të kufizuara. Në këtë kontekst, raporti ka ofruar një sërë rekomandimesh për të siguruar një reagim dhe rimëkëmbje adekuate për personat me aftësi të kufizuara me theks në orientimin në fushat siç janë: qasja, pjesëmarrja, llogaridhënia dhe ndarja e të dhënave.⁴

Ndërsa, zbatimi i masave mbrojtëse që janë kërkuar nga OKB dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, janë si në vijim: Shëndeti/sigurimi i qasjes në informata për shëndetin publik; zbatimi i masave mbrojtëse kundër COVID-19; sigurimi i qasjes në shërbime; sigurimi i mos-diskriminimit në alokimin e resurseve të pakta mjekësore; ndërhyrje gjithëpërfshirëse në shëndetin mendor të personave me aftësi të kufizuara; Mbrojtja e personave të vendosur në institucione/ulja e numrit të njerëzve brenda institucioneve; Shërbimet mbështetëse/sigurimi i vazhdimësisë së shërbimeve mbështetëse; zgjerimi mbështetës së komunitetit për personat me aftësi të kufizuara; Mbrojtja sociale dhe punësimi; Edukimi-Arsimi/ adresimi i ndikimeve që shkojnë përtej të mësuarit; Parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës/ sigurimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të arritshme të mbështetjes ndaj viktimave: ngritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive: dhe Kontekstet Humanitare.⁵

SHËNDETËSIA

Objektiva Strategjike 1: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuar

Në kuadër të Objektivës Strategjike 1 janë paraparë tre objektiva specifike si më poshtë:

Objektivi Specifik 1: Ngritja e kapaciteteve të personelit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore - objektivi i cili përfshinë 6 aktivitete të parapara të cilat kanë të bëjnë me, 1.1. Ofrimin i shërbimeve shëndetësore për PAK në kuadër të vizitave shtëpiake, 1.2 Vaksinimi i personave me aftësi të kufizuara me vaksinë të gripit sezonal, 1.3. Hartimi i materialeve për promovim shëndetësor të personave me aftësi të kufizuar dhe edukim shëndetësor për punëtorët shëndetësor, 1.4 Realizimi i shërbimeve shëndetësore ndaj PAK 1.5. Trajnime për stafin infermierik dhe stafin mbështetës në tematikat e qasjes dhe trajtimit të personave me aftësi të kufizuar, 1.6. Koordinimi i aktiviteteve me MFPT.

Objektivi Specifik 2: Përfshinë, Zbulimin e hershëm dhe identifikimin e aftësisë së kufizuar prej kohës perna- tale, natal edhe postnatale - objektivi i cili përfshinë 2 aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me 2.1. Realizimi i hulumtimeve në fushën e konditave shëndetësore që ndërlidhen me PAK si dhe 2.2. Realizimi i programit për edukim shëndetësor për prindër në zbulimin të shkaktarëve që rezultojnë në aftësi të kufizuar.

⁴ United Nation/Policy Brief/ A Disability -Inclusive Response to COVID-19, May 2020 <https://reliefweb.int/report/world/policy-brief-disability-inclusive-response-covid-19-may-2020>

RAPORTI VJETOR PËR AFTËSINË E KUFIZUAR, Zyra e Bashkimit Evropian; Handikos 2020

⁵ United Nation/Policy Brief/ A Disability -Inclusive Response to COVID-19, May 2020 <https://reliefweb.int/report/world/policy-brief-disability-inclusive-response-covid-19-may-2020>;RAPORTI VJETOR PËR AFTËSINË E KUFIZUAR, Zyra e Bashkimit Evropian; Handikos 2020

Objektivi Specifik 3: Krijimi dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore për PAK -objektivi i cili përfshinë gjithësejt 6 aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me 3.1. Hulimtimi i nevojave mbi plotësimin e listës esenciale të barnave, 3.2. Vazhdimi i ofrimit të ekzaminimeve (Mamografi dhe PAP test) për femrat me aftësi të kufizuara si dhe 3.3. Kujdesi për higjienën orale për fëmijet me aftësi të kufizuara. 3.4. Hartimi i PSO-ve për trajtim specifik shëndetësor për PAK, 3.5. Hartimi i qarkores informative për njoftimin e institucioneve shëndetësore me numrin e qendrës për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave si dhe 3.6. Realizimi i vizitave në komunitet për promovim dhe edukim shëndetësor për personat me aftësi të kufizuara.

MIRËQENIA SOCIALE

Objektiva Strategjike 2: Sistem funksional dhe i mirëfillt për mirëqenien dhe sigurinë sociale si dhe ofrimin e mundësive të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Objektivi Specifik 1: Shtrirja e shërbimeve në komunitet -Objektiv i cili përfshinë 10 aktivitete e që janë: 1.1 Implementimi i Skemës pensionale për personat me aftësi të kufizuara, të moshës 18-65 vjeç. 1.2. Zbatimi i skemave të përfitimeve dhe kompenzimeve; 1.3. Zbatimi i Ligji 03/L-022 për Përkrahje Materiale për Familje me Aftësi të Kufizuara të Përhershme, 1.4. Implementimi i Skemës për Kompensimin e Personave të Verbër, 1.5. Implementimi i Skemës për Kompensimin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, 1.6. Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit Gjithëpërfshirës të Aftësisë së Kufizuara, 1.7 Trajnimi i Komisionit Bio-Psiko-Social për përdorimin e instrumentit të KNF-s, 1.8. Vazhdimi i ofrimit të shërbimeve në qendrat rezidenciale (ISSH) 1.9 Licencimi individual dhe i OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve sociale për PAK., 1.10. Fuqizimi i mekanizmit monitorues dhe inspektues për shërbimet dhe fondet e organizatave përfituese, 1.11. Përcaktimi i kodit buxhetor për shërbimet sociale.

Objektivi specifik 2- Përfshinë krijimin e kushteve të barabarta për Punësimin e PAK -Objektiv i cili parashihet të ketë 5 aktivitetet e që janë: 2.1. Ofrimi i Shërbimeve për PAK në Shërbime të Karrierës, 2.2. Fuqizimi i inspektoratit të punës për monitorimin e zbatimit të Ligjit Nr.03/019 për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim, 2.3. Ndërmjetsimi i PAK në punësim, 2.4. Përfshirja e PAK në punësim përmes Masave Aktive të Tregut të Punës, 2.5. Fushatat vetëdijësuese për punësimin e PAK në sektorin publik dhe privat.

Objektivi specifik 3 - Aftësimi dhe riaftësimi profesional për përgatitjen e Personave me Aftësi të Kufizuara për Tregun e punës - objektivi i cili parashihet t'i ketë 5 aktivitete 3.1 Zgjerimi i profileve për aftësim dhe riaftësim profesional sipas kërkesave të tregut të punës, 3.2. Trajnimi i PAK në Qendrat e Aftësimit Profesional, 3.3. Kurrikulat e adaptuara për personat me aftësi të kufizuara, 3.4. Adaptimi i punëtorive me pajisje për nevojat e personave me aftësi të kufizuara, 3.5. Trajnimi i trajnerëve të QAP për implementimin e kurrikules së adaptuar për PAK.

ARSIMI

Objektiva Strategjike 3: Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara.

Objektivi Specifik 1: Krijimi i mekanizmave për identifikimin dhe edukimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Përfshinë 4 aktivitete të cilat janë: 1.1.Hartimi i 3 udhëzuesve edukatore për qasjen dhe punën me fëmijët me aftësi të kufizuara, 1.2.Ngritja e kapaciteteve të edukatoreve për zbatim të udhëzuesve, 1.3.Hartimi dhe ofrimi i materialeve pedagogjike në 2 platformat e MASHTI, 1.4.Fushatë vetëdijesuese për rëndësinë e intervenimit të hershëm për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Objektivi Specifik 2: Krijimi, fuqizimi dhe përmirësimi i shërbimeve të mekanizmave ndër-sektorial dhe mekanizmave tjerë mbështetës për shkollën gjithëpërfshirëse

Përfshinë 5 aktivitete të cilat janë: 2.1. Punësimi /apo sigurimi i mësuesve mbështetës në shkolla, 2.2. Punësimi i asistenteve në mbështetës në shkolla, 2.3. Ngritja e kapaciteteve të ekipeve vlerësuese për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja, 2.3.1 Ofrimi i shërbimeve në Braille, orientim dhe mobilitet për fëmijët e verbër në sholla të rregullta, 2.4. Ngritja e kapaciteteve të mësimitdhënësve për qasjen dhe punën me nxënësit me aftësi të kufizuara.

Objektivi Specifik 3: Të krijohet një mjedis i përshtatshëm për gjithëpërfshirje në shkollë dhe komunitet

Përfshinë 7 aktivitete të cilat janë: 3.1.Hartimi i planit 5 vjeçar për qendrat burimore, 3.2.Ngritja e shërbimeve nga qendrat burimore për shkollat e rregullta, 3.3.Ngritja e kapaciteteve të stafit në qendra burimore, 3.4.Hartimi dhe akreditimi i programeve të trajnimeve për mësimitdhënës në shkollat të rregullta, 3.5.Hartimi dhe akreditimi i programeve nga AKK për shkrimin e Braille dhe gjuhën e shenjave, 3.6.Ofrimi i kurseve për mësimitdhënës, asistente dhe prindër për shkrimin e Braille dhe gjuhën e shenjave, 3.7. Zhvillimi i programit, Niveli 5 në gjuhën e shenjave.

Objektivi specifik 4: Përfshinë Ngritjen e cilësisë së mësimitdhënies dhe të nxënësve në arsimin gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet e arsimit para-universitar.

Përfshinë 5 aktivitete të cilat janë: 4.1. Hartimi i dokumentit për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e mesëm të lartë me specifikat e shkollat e AAP, 4.2. Hartimi i udhëzuesve për mësimitdhënës për qasjen, punën pedagogjike dhe specifikat e nxënësve me aftësi të kufizuara, 4.3. Ngritja e kapaciteteve të mësimitdhënësve për qasjen dhe specifikat e nxënësve me aftësi të kufizuara, 4.4. Ofrimi i arsimit jo formal në qendrat burimore, 4.5. Përdorimi i materialeve gjatë procesit të punës së mësimitdhënësve (materialet e hartuara nga OJQ-te).

MBROJTJA LIGJORE

Objektiva Strategjike 4: Qasje e barabartë në mbrojtje ligjore si dhe ofrimi i shërbimeve në nivelin lokal për përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara

Objektivi Specifik 1: Hartimi i ligjeve në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të Personave me Aftësitë Kufizuara

Është i përfshirë 1 aktivitet: 1.1. Përfshirja e OPAK në hartim të legjislacionit

Objektivi Specifik 2: Ndryshimi dhe plotësimi i kornizës aktuale ligjore për PAK

Rritja e bashkëpunimit me OPAK përmes konsultimit të tyre në hartimin e politikave qeveritare. Janë të përfshira 2 aktivitete: 1.1. Zbatimi i Rregullores QRK 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave, 1.2. Koordinimi rreth Funkcionalizimit të Këshillit Nacional për Aftësinë e Kufizuar.

Objektivi Specifik 3: Ngritja e kapaciteteve të stafit profesional në sistemin e drejtësisë për të drejtat e PAK

Janë të përfshira gjithësejt 4 aktivitete: 3.1. Trajnimi i stafit në Shërbimet Sprovuese dhe Korrektuese, 3.2. Hartimi i udhëzuesit informues për të drejtat e personave e aftësi të kufizuar në sistemin drejtësisë, 3.3. Ngritja e kapaciteteve të PK-së përmes Trajnimit të zyrtarëve policor për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave mbi specifikat e PAK, 3.4. Hartimi i udhëzuesit për trajtimin e PAK bazuar në specifikat e aftësisë së kufizuar.

QASJE, INFORMIM, KOMUNIKIM, PJESËMARRJE DHE STATISTIKA

Objektiva Strategjike 5: Krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesëmarrje si dhe në krijimin apo vendosjen e një sistemi të unifikuar të të dhënave për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Objektivi Specifik 1: Hulumtimi sipas nevojës mbi gjendjen në terren lidhur me qasjen në objekte për PAK

Janë të përfshira 7 aktivitetet të cilat janë: 1.1. Aktiviteteve vetëdijësuese me këtë komunitet, respektivisht takime me OJQ-të që paraqesin interesat e personave me aftësi të kufizuara, me theks të veçantë integrimi dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara, 1.2. Punëtori e organizuara për OJQ-të për personat me aftësi të kufizuar, 1.3 Fushatë vetëdijësuese për dhenjen e grandeve në bujqësi për personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit e fëmijëve PAK, MBPZHR, 1.4. Promovimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në zonat rurale për mundësinë e aplikimit në subvencione dhe grande, 1.5 Promovimi, bashkëpunimi dhe avancimi i të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar në komuna, 1.6. Promovimi i të drejtave të njeriut në komuna/ PAK. Përfshirja PAK plotësisht në jetën shoqërore me kushte të barabarta si të gjithë, 1.7. Hartimi i Planit Komunal të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuar në komuna.

Objektivi Specifik 2 : Sigurimi i qasjes në objekte për PAK

Përfshinë 1 aktivitet e që është : 2.1. Zbatimi i Udhëzimit Administrativ 33/2007 "Për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuar"

QËLLIMI I PLANIT NACIONAL PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA 2021-2023

Procesi i realizimit të të drejtave të qytetarëve me aftësi kufizuar dhe i përmbushjes së prioriteteve të Strategjisë dhjetë vjeçare për Personat me Aftësi të Kufizuar është një proces i cili kërkon vazhdimisht përpjekje nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe e gjithë shoqëria jonë.

Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2023 është plani i tretë në kuadër të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2023 në nivel vendi, dhe në çdo aspekt ka për qëllim të avancojë çdo herë e më tej të drejtat e personave me aftësi të kufizuara deri në arritjen e qëllimit final për krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse në të cilën personat me aftësi të kufizuara realizojnë potencialin plotë të tyre dhe kanë të drejtën të jetojnë një jetë të dinjitetshme.⁶

Ky dokument përkundër gjendjes së pandemisë është hartuar duke mbajtur punëtori në muajin Tetor të 2020, konform çdo objektivi strategjik me ministritë përkatëse dhe OPAK.

Ky dokument është i rëndësishëm ngase adreson nevojat dhe prioritetet e të gjithë personave me aftësi të kufizuara, pavarësisht moshës, gjinisë, e që në total përbëjnë 93,288 të popullatës në Republikën e Kosovës.⁷

Të gjitha veprimet dhe aktivitetet e përcaktuara konform objektivave strategjike në këtë dokument, janë përcaktuar në atë mënyrë që t'i përmbushin nevojat në pesë fushat më me prioritet sa i përket të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, përfshirë, shëndetësinë, mirëqenien sociale, arsimin, mbrojtjen ligjore si dhe çasjen komunikimin gjithëpërfshirës.

Çdo veprim i paraqitur në kuadër të Planit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2023 është punuar në bashkëpunim me organizatat për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe në bashkëpunim me Projektin e financuar nga BE-ja, i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë e zbatuar nga: Handikos, në partneritet me SHKSH, SHVK, DPF Threshold "Promovimi gjithëpërfshirës në proceset konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuara në nivel Lokal, Nacional dhe Regjional" në miratim të plotë nga institucionet përgjegjëse përkatësisht ministritë e linjës të cilat dhe zotohen në realizimin dhe përmbushjen e aktiviteteve konform afatit të zbatimit dhe kostos së realizimit të aktivitetit. Si përfundim, Republika e Kosovës me Planin Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2021-2023, ka për mision të jetësojë të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë dokument në mënyrë që jeta e personave me aftësi të kufizuara të përmirësohet edhe më tej.

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

ZKM/ZQM është e mandatuar që të realizojë monitorimin e zbatimit të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023 dhe si rrjedhojë edhe të Planit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2023.

Bazuar në mandatin e **ZKM/ZQM**, që nga miratimi i Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ka vënë në fokus kryesor monitorimin dhe implementimin e dokumenteve të hartuara të rëndësishme sa i përket sektorit të Aftësisë së Kufizuara.

Politikat e monitorimit të **ZKM/ZQM** përfshijnë bashkëpunimin e ngushtë dhe koordinimin në nivel qendror me ministritë e linjës gjithashtu me të gjitha komunat e Republikës së Kosovës poashtu koordinimin me agjensionet e pavarura, institucionet ndërkombëtare si dhe organizatat që punojnë për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Gjithsesi, politikat e

⁶ Plani Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2018-2020, Prishtinë

⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës "Regjistrimi i popullësisë dhe banesave në Kosovë 2011-Rezultatet përfundimtare

monitorimit arrijnë në një nivel të dëshiruar edhe përmes mekanizmave institucional të cilët koordinohen po nga **ZKM/ZQM** dhe janë të shtrira në dy nivele : nivel të lartë hierarkik të udhëhequr nga zv. Kryeministri në përbërje të pesë zv. Ministrave, si dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara që merren kryesisht me orientimin e politikave të përgjithshme në sektorin e Aftësisë së Kufizuar, si dhe nivel operativ një komisioni i emëruar nga sekretari i përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që përbëhet nga zyrtarë të ministrive të ndryshme dhe organizata të personave me aftësi të kufizuara.

Monitorimi dhe raportimi kundrejt Planit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2023 do të realizohet në baza vjetore për të vlerësuar të gjitha të arriturat dhe sfidat në përmbushjen e objektivave dhe veprimeve të parapara në këtë dokument. Gjithësesi Plani Nacional i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2023 përcakton veprimet kryesore nën çdo objektivë specifike, të cila identifikojnë gjithashtu edhe institucionet përgjegjës dhe afatet kohore për implementimin e tyre. Kur një institucion është përgjegjës për implementimin e një aktiviteti, gjithashtu janë të identifikuar edhe institucionet tjera të cilat do të ndajnë përgjegjësin apo edhe ato që do të ndihmojnë në zbatimin e tyre e që në këtë rast janë kryesisht donatorët dhe partnerët e përhershëm, organizatat për personat me aftësi të kufizuara.

ZKM/ZQM ka një kornizë të monitorimit mbi bazën e së cilës do të masë progresin, ndërsa institucionet përgjegjëse janë të obliguara të hartojnë plane më të detajuara të veprimit, të cilat ofrojnë hollësi më të detajuara për secilin departament në kuadër të institucionit përgjegjës. Planet e Veprimit më të detajuara do të mundësojnë monitorimin e progresit nga secili departament. Në këtë mënyrë në përputhje me të gjitha objektivat specifike të çdo fushe të veprimit, të gjitha institucionet përgjegjëse do të reflektojnë mbi masat e ndërmarra për zbatimin e çdo aktiviteti të planifikuar. Institucionet përveç që kanë përgjegjësi t'i bashkërendisin të gjitha veprimet specifike që dalin nga objektivat specifike të këtij dokumenti, ato duhet gjithashtu të vlerësojnë dhe sigurojnë që të gjitha programet dhe planet sektoriale në kuadër të institucionit të jenë në linjë me këto objektiva. Si rrjedhojë raportet e paraqitura do të vlerësohen mbi bazën e indikatorëve matës dhe afateve kohore.⁸

Ndikimet Financiare në Implementimin e Strategjisë Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar ne Republikën e Kosovës (2013-2023)

Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjise për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut ka një kosto totale të zbatimit prej **122,700,964.00 Euro** për tri vite të zbatimit (2021-2023). Pjesa më e madhe e koston (rreth 95% e buxhetit) do të përdoret për shpenzimet rrjedhëse që lidhen me ngritjen e kapaciteteve, rregullimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit që kanë të bëjë me të drejtat e njeriut.

Tabela 1. Jep një përmbledhje të buxhetit për zbatimin e Planit sipas dhe viteve, ndërsa kjo bazohet në kalkulime të detajuara të shpenzimeve për secilin objektivë të planifikuar, ndërsa tabela 2 jep një përmbledhje të buxhetit për zbatimin e Planit sipas burimeve të financimit.

⁸ Plani Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar ne Republikën e Kosovës 2018-2020, Prishtinë

Zbatimi i planit të veprimit për 3 vitet e para do të kërkojë mjete financiare siç tregohet në tabelën më poshtë në milionë euro (KT- Buxheti i përgjithshëm për Planin e Veprimit, KR- kostot rrjedhëse, K – kapital kapitale, SG – subvencionet dhe grantët).

Tabela 1. Përmbledhja e buxhetit sipas objektivave dhe viteve

Objektivat Strategjike	2021				2022				2023			
	KT	KR	K	SG	KT	KR	K	SG	KT	KR	K	SG
Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara	0	0	0	0	45,00 0.00	45, 000 .00	0	150 0.0 0	27, 500 .00	27, 500 .00	0	12,000.00
Sistem funksional dhe i mirëfilltë për mirëqenien dhe sigurinë sociale, si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara	42,1 37,3 80.0 0	42,1 37,3 80.0 0	0	41, 278 ,98 0	38,97 5,880. 00	38, 975 ,88 0.0 000	0	38, 091 ,98 0.0 0	38, 976 ,38 0.0 0	38, 976 ,38 0.0 0	0	38,091,98 0.00
Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara;	67,7 000. 00	67,7 000. 00	0	12, 000 .00	866,6 62.00	866 ,66 2.0 0	0	11, 00. 00	865 ,16 2.0 0	865 ,16 2.0 0	0	13,000.00
Krijimi i infrastrukturës ligjore për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara	40,0 00.0 0	40,0 00.0 0	0	0	40,00 0.00	40, 000 .00	0	0	40, 000 .00	40, 000 .00	0	0
Krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesëmarrje si dhe krijimin e një sistemi të unifikuar të të dhënave për Personat	3000 .00	3000 .00	0	0	3500. 00	350 0.0 0	0	0	350 0.0 0	350 0.0 0	0	0

me Aftësi të Kufizuara												
Totali:	42,857,380.00				39,931,042.00				39,912,542.00			
Nën-totali 2021-2023:	122,700,964.00 Euro											

Tabela 2. Struktura e shpenzimeve sipas viteve të planifikuara në plan të veprimit dhe burimit të financimit

Vitet	Shpenzime totale		
	BRK	Donatorët	Total:
2021	42,804,680.00	52,700.00	42,857,380.00
2022	39,866,542.00	64,500.00	39,931,042.00
2023	39,849,042.00	63,500.00	39,912,542.00
Total:	122,520,264.00	180,700.00	122,700,964.00 Euro

Shpërndarja e kostos në kategori të shpenzimeve dhe sipas viteve është si vijon:

Ministrit e linjës	Paga dhe medijtje	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Kapitale	Subvencione dhe Transfere
Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit	27,400.00- (2021) 787,662.00(2022) 787,662.00 (2023)	40,300.00 (2021) 79,000.00 (2022) 77,500.00 (2023)		
Ministria e Shëndetësisë		45,000.00 (2022) 27,500.00 (2023)		
Ministria e Financave Punës dhe Transfereve		858,400.00 (2021) 883,900.00 (2022) 884,400.00 (2023)		40,178,980.00 (2021) 36,991,980.00 (2022) 36,991,980.00 (2023)
Tjera (Komunat, ZKM/ ZQM, MD)		1,752,300.00 (2021) 1,143,500.00 (2022) 1,143,500.00 (2023)		
Gjitheshej ne vite	27,400.00- (2021) 787,662.00(2022) 787,662.00 (2023)	2,651,000.00 (2021)		40,178,980.00 (2021) 36,991,980.00 (2022)

		2,151,400.00 (2022) 2,132,900.00 (2023)		36,991,980.00 (2023)
Gjithsejt	122,700,964.00 Euro			